REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.29, datë 20/07/2005

"PËR PAJISJE ME AUTORIZIM DEFINITIV NË RRUGËN E DIBRËS, ISH-LABORATORI BIOKIMIK, PRANË QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE"

Këshilli Bashkiak i Tiranës pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore "Për pajisje me autorizim definitiv në Rrugën e Dibrës, ish-Laboratori Biokimik, pranë Qendrës Spitalore Universitare", mbështetur në ligjin Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32, gërma "e", në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.49, dt.29/01/1993 "Për përcaktimin e kritereve për të pastrehët", në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.43, dt.09/05/1995 "Për kalimin ne fond banese të bodrumeve", si dhe në Dekretin e Presidentit Nr.1440, dt.04/04/1996 "Për privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara",

V E N D O S I;

1. Të pajisë më autorizim definitiv qytetarin Bardh Markoçi për bodrumin (1+1) në Rrugën e Dibrës, ish-Laboratori Biokimik, pranë Qendrës Spitalore Universitare.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore.

3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI